



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

V E N D I M

Nr. 87, Datë 29.08.2017

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me 72, datë 02.08.2017, të paraqitur nga subjekti ankues Y. M., me objekt pretendimin për diskriminim “*për shkak të racës¹*”, nga ana e Bashkisë së Beratit.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Shtetasi Y. M. pretendon se: *“Jetoj me 4 (katër) kurora në një shtëpi. Kërkoj të pajisem me një kredi të butë për të bërë një jetesë normale. Dua të më mundësohet ndërmjetësim me Bashkinë e Beratit në mënyrë që të përfitoj një kredi të butë.”*

Në këto kushte, ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: *“Të lehtësohet për marrjen e një kredie të butë.”*

Raca është një nga shkaqet për të cilat Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

¹ Y. M. shprehet se i përket komunitetit rom.

1. Me anë të shkresës me Nr. 774/1 Prot., datë 15.08.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga ana e Bashkisë Berat, lidhur me ankesën bërë nga Y. M., për përfitimin e kredisë së butë.

Me shkresën me Nr. 3585/1 Prot., datë 21.08.2017, nga ana e Bashkisë Berat, sqarohet se “... Bashkia Berat aktualisht është në zbatim të dy programeve të Strehimit Social, programi i bonusit të qirasë dhe programi i ndërtimit të banesave me kosto të ulët nga Enti Kombëtar i Banesave. Programi i kredisë së zbutur nuk është në zbatim që nga viti 2013 edhe pse është një nga programet që ka më shumë kërkesa nga familjet e pastreha, sidomos nga familjet e reja. Y. M. nuk ka aplikuar si i pastrehë pranë Bashkisë Berat për t’u trajtuar me programin e kredisë së zbutur.”

Pas vlerësimit të fakteve dhe provave të grumbulluara gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri vlerëson se:

Bazuar në përgjigjen shkresore sa më sipër, nuk rezulton të ketë diskriminim nga ana e Bashkisë Berat, pasi jemi në situatën kur subjekti ankues nuk është paraqitur pranë njësisë vendore ku figuron i regjistruar, për të aplikuar për përfitimin nga programi i kredisë së butë, duke plotësuar fillimisht formularin tip të strehimit. Gjithashtu rezultoi se Bashkia Berat, nuk disponon që prej vitit 2013, programin e kredisë së butë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a) dhe c), nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminit për shkak të racës, ndaj Y. M., nga ana e Bashkisë Berat.
2. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i rekomandon subjektit ankues, se nëse kërkon të përfitojë nga Programet e Strehimit Social që disponon Bashkia Berat, të paraqitet pranë kësaj njësie vendore, për të plotësuar fillimisht formularin tip të strehimit, dhe më pas për të depozituar dokumentacionin e kërkuar prej tyre.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

KOMISIONERI

Irma BARAKU

(Shkaku: Raca)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)